

Numri i lëndës: 2024:036570

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05521892

**C.nr.708/2024**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA V.**, me gjyqtarin Raif Fazliu dhe bashkëpunëtoren profesionale Dardana Behluli, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.H.nga fshati P., Komuna V., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson S.B., avokat në V., kundër të paditurës Komuna V.-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensimi sipas kualifikimit shkollor, vlera e kontestit 1,383.75 €, jashtë seancës, me datë 28.03.2024, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I. Miratohet e bazuar** kërkesëpadia e paditëses A.H.nga fshati P., Komuna V., **detyrohet** e paditura Komuna V.-Drejtoria Komunale e Arsimit që paditëses, në emër të kompensimit shtesë të të ardhurave personale për licencim, për periudhën nga data 01.01.2021 deri më 31.01.2023, përkatësisht për 25 muaj, t’ia paguajë nga 55.35 €, në shumë të përgjithshme 1,383.75 €, me kamatë ligjore 8 %, e llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë me 31.01.2024, deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

**II.** Detyrohet e paditura që paditëses t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumë 135 €, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i aktgjykimit, nën pasojën e përmbarimit ligjor.

### **A r s y e t i m**

I autorizuari i paditëses A. H., avokati S.B. me datë 31.01.2024, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimi në bazë të licencimit, vlera e kontestit 1,383.75 €.

Në padi, ka theksuar se është e punësuar si mësimdhënëse në ShFMU “K.H.” në fshatin G. ku vazhdon të punojë edhe sot. Meqenëse paditësja është me diplomë fakulteti për të cilin fakt i takon shtesa e të ardhurave personale apo 27 % e pagës bazë prej 421 € në muaj edhe atë, në përputhje me Ligjin e Punës dhe Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë (tutje KKAK), ndërsa e paditura e ka paguar atë vetëm 58.32 €, duke i mbetur borxh nga 55.35 € për muaj, nga gjykata ka kërkuar që në emër të kompensimit shtesë të të ardhurave personale për licencim, për periudhën nga data 01.01.2021 deri me 31.01.2023, përkatësisht për 25 muaj, t’ia paguajë shumën 1,383.75 €. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, shumën 104 € për përpilimin e padisë dhe 31 € për taksën gjyqësore për padi.

E paditura, në përgjigje në padi e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, me pretendimin se kërkesa nuk është e bazuar në ligj, pasi obligimet e parapara nga Kontrata Kolektive e Arsimit të Kosovës duhet të paguhet nga niveli qendror, Ministrinë përkatëse dhe anën tjetër, ka theksuar se Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit e kanë shkëputur këtë kontratë andaj rrjedhimisht edhe nuk mund të prodhojë obligim ligjor për të paditurën. Tutje ka theksuar se paditësja ka nënshkruar kontratën e punës sipas kualifikimit mësimdhënës, kriter ky për themelimin e marrëdhënies së punës në bazë të së cilës edhe realizon të ardhura sipas kësaj pozite. E paditura gjithashtu është thirrur edhe në parashkrim të kërkesës

së paditëses, duke theksuar se ka kaluar afati i paraparë prej tri vitesh për të realizuar këtë të drejtë andaj, gjykatës i ka propozuar që të refuzojë kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar në ligj. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje LPK), me të cilin përcaktohet se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigjja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritator atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesë padinë” dhe në rastin konkret, ka ardhur në përfundim se të gjitha kushtet ligjore të përcaktuara në këtë nen janë plotësuar pasi që gjendja faktike nuk është kontestuese e po ashtu nuk ekzistojnë pengesa të tjera që pa caktuar seancë gjyqësore të pranohet si e themeltë kërkesëpadia e paditëses, pasi themelësia e kërkesëpadisë është e bazuar në Vendimin e Qeverisë nr. 01/33, të datës 29.08.2008.

Gjykata ka gjetur se asnjë nga faktet e paraqitura në padi nuk janë kontestuese, se paditësja është mësimsdhënëse e kualifikuar me fakultet, paga bazë e të cilës është 421.00 €, ndërsa nga e paditura është kompensuar vetëm pjesërisht apo më saktë vetëm nga 58.32 € në muaj, duke i mbetur kështu borxh nga 55.35 € për muaj, fakte këto të mbështetura nga Vërtetimi i punës nr. 2321/23, i datës 17.08.2023, Vërtetimi nr. 2116/2021, i datës 31.12.2021, Licenca nr. 1030696, e datës 01.12.2021 dhe Lista e pagave EM 00158442, prova këto vendimtare për vendosje në këtë çështje kontestimore, pasi janë lëshuar nga organi kompetent, këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës, duke provuar kështu saktësinë e thënieve në këto dokumente, ashtu siç është paraparë në nenin 329.1 të LPK-së.

Duke pasur parasysh faktin se e paditura nuk i ka mohuar faktet vendimtare e as gjendjen faktike por vetëm bazën e kërkesëpadisë, gjykata ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor, pasi themelësia e kërkesëpadisë së paditëses, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del e mbështetur në dispozitat e nenit 55. 1 të Ligjit të Punës që përcakton se: “I punësuari ka të drejtë në pagë e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenit 90. 5 i cili ka përcaktuar: “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”, lidhur me dispozitat e KKAK-së së datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, përkatësisht neni 3. 2 i cili ka përcaktuar se: “I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratën Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”.

Në Vendimin e Qeverisë nr. 01/33, të datës 29.08.2008, në fuqi deri me datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik nr. 08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimsdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimsdhënësit, drejtorët, zëvendës drejtorët dhe bashkëpunorët profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike 19 %, me diplomë universitare 3 dhe 4 vjeçar 27 % dhe me diplomë të 5 vjeçare, master dhe doktoraturë 35 % të pagës bazë. Zbatimi i këtij vendimi të Qeverisë, rastet e kualifikimit-licencimit, është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 214/2023, të datës 05.10.2023.

Në këtë çështje kontestimore, gjykata vlerësoi se e paditura nuk ia ka kompensuar paditëses pagën sipas përqindjes për shkak të kualifikimit shkollor sepse e ka paguar atë vetëm pjesërisht ndërsa i ka mbetur borxh nga 55.35 € për çdo muaj, pasi sipas përqindjes së përcaktuar në

Vendimin e Qeverisë është dashur të paguhet 27 % të pagës bazë, e për këtë arsye e detyroi të paditurën si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës lidhur me faktin e zbatimit ose jo të kontratës kolektive, gjykata i gjeti të pa bazuara këto pretendime, pasi në rastin konkret baza juridike e kërkesës së paditëses buron nga Vendimi i Qeverisë. Edhe pretendimin se paditësja është pranuar në punë sipas këtij kualifikimi dhe në kontratën e tij të punës përcaktohen përqindjet sipas kualifikimit, për gjykatën ishte fakt jo relevant për këtë çështje kontestuese pasi përqindjet sipas kriterëve të licencimit të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë dhe në kontratë të punës kanë dallim mes vete dhe mësimdhënësit nuk kompensohen sipas këtyre kriterëve. Gjithahtu, sa i përket asaj se e paditura është thirrur në parashkrim të kërkesës së paditëses, gjykata ka gjetur se kërkesëpadija e paditëses është e afatshme përkatësisht, kërkesa ka të bëjë me periudhën nga data 01.01.2021 deri me 31.01.2023 ndërsa paditësja ka ushtruar padi me datë 31.01.2024 pra, brenda afatit të përcaktuar kohor prej 3 viteve (neni 87 i Ligjit të Punës).

Lidhur me kumatën gjykata ka vendosur në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke u mbështetur në nenin 449 lidhur me nenin 452.1 dhe 463.1 të LPK-së, pasi e paditura e ka humbur kontestin dhe për këtë arsye u detyrua të paguajë shpenzimet e paditëses edhe atë, për taksën gjyqësore për padi shumën 31 € dhe për përpilimin e padisë shumën prej 104 €.

Nga të lartcekurat, e duke u mbështetur edhe në nenin 142 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA V.

C.nr.708/2024, Datë 28.03.2024

Gj y q t a r i,  
Raif Fazliu

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimiit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.